




Nr. 24 prot  
datë 17/07/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 19, datë 12.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME TË TJERA, TË SUBJEKTIT  
“REJDI PRENDI” P.F, ME VENDNDODHJE: FSHATI DARDHË,  
BASHKIA FUSHË ARRËZ, QARKU SHKODËR.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në formularët e tjerë), të subjektit “Rejdi Prendi” P.F, me vendndodhje: Fshati Dardhë, Njësia Administrative Blerim, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Trupat ujor sipërfaqësorë të malit Kunor Dardhës.

Vendndodhja e burimit uJOR (KRGJSH).

**Burimi Nr.1**

$$X_1 = 512048$$

$$Y_1 = 4670510$$

$$Z_1 = 985 \text{ m.m.n.d}$$

$$Q_{1\text{kërkuar}} = 11 \text{ l/sek}$$

$$Q_{1\text{mes-vje}} = 22 \text{ l/sek}$$

$$Q_{1\text{eko}} = 1.1 \text{ l/sek}$$

**Burimi Nr.2**

$$X_2 = 511817$$

$$Y_2 = 4670502$$

$$Z_2 = 1042 \text{ m.m.n.d}$$

$$Q_{2\text{kërkuar}} = 4 \text{ l/sek}$$

$$Q_{2\text{mes-vje}} = 8 \text{ l/sek}$$

$$Q_{2\text{eko}} = 0.4 \text{ l/sek}$$

**Burimi Nr.3**

$$X_3 = 511672$$

$$Y_3 = 4670566$$

$$Z_3 = 1065 \text{ m.m.n.d}$$

$$Q_{3\text{kërkuar}} = 5 \text{ l/sek}$$

$$Q_{3\text{mes-vje}} = 11 \text{ l/sek}$$

$$Q_{3\text{eko}} = 0.55 \text{ l/sek}$$

Qëllimi i përdorimit të ujit: Bar - Restorant - Hotel Alpin Dardhë dhe strukturave të reja akomoduese, qëllime sanitare dhe akuapark.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH).

$$X = 512248$$

$$Y = 4670928$$

$$Z = 821 \text{ m.m.n.d}$$

Prurja që shkarkohet:  $Q = 14 \text{ l/sek}$

Trupi uJOR pritës: Trupi uJOR i përroit Dardhë.

3. Leja për përdorim burimi uJOR jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve UJORE për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

